


Përmbajtja

Historiku	3
Konteksti	3
Roli ynë	4
Analiza	5
Misioni dhe Vizioni.....	5
I. MBROJTJA DHE PROMOVIMI I VLERAVE KULTURORE-ARTISTIKE	6
II. FUQIZIMI I RINISË	7
III. PROMOVIMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM.....	8
Strategjia implementuese.....	9
Rrjetëzimi.....	10
Plani i Veprimit.....	11
Monitorimi dhe Vlerësimi.....	11



Historiku

Organizata 7Arte u krijua në maj 2006 nga një grup artistësh vendas në Mitrovicë, Kosovë. Me një përvojë 16 vjeçare, 7Arte luan rolin e një qendre alternative kulturore duke përdorur aktivitete kulturore multidisiplinare të tilla si: punëtori audio-vizuale, festivale muzikore, shfaqje në ambient të hapur, aktivitete artistike në rrugë, netë me poezi, programe shkëmbimi dhe programe edukimi dhe aktivitete mjedisore. Që nga viti 1989-2000 rinia dhe kultura në Kosovë, pësoi një humbje të madhe e cila la pasoja të dukshme edhe në vitet pasuese, të njohura si faza e tranzicionit apo e pasluftës. Rimëkëmbja e kulturës dhe aktivizimit qytetar, posaqërisht i të rinjve, mbeti sfidë e vazhdueshme e shoqërisë. Duke parë nevojën për zhvillim kulturor dhe aktivizim të të rinjve, më 2 maj të vitit 2006, me iniciativën e artistëve vendor u themelua organizata kulturore "7arte". Në po të njëjtin vit, kjo organizatë antarësohet në Rrjetin e Kinemasë së Re Evropiane NISI MASA, me çrast artistëve të rinj u ofron mundësi më të shumta për bashkëpunim dhe promovim kulturor. Krahas programeve kulturore, vizitave studimore, e shkëmbimeve të përvojave, 7arte arriti të ofrojë përvoja të reja profesionale për një numër të konsiderueshëm të artistëve kosovarë, si dhe të ndërtojë partneritete të dobishme në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Konteksti


Ne besojmë se kultura, artet dhe gjithë industria kreative e prodhuar në Kosovë, vetëm se do ta plotësonte boshllëkun e mozaikut kulturor evropian. Artet dhe kultura janë thelbi i çdo qytetërimi e zhvillimi. Ato janë thelbësisht të rëndësishme për identitetin tonë, i japin kuptim ekzistencës njerëzore dhe pasqyrojnë historinë tonë të përbashkët. Në botën e sotme dixhitale, artet paraqesin të paparashikuarat dhe hapin perspektiva të reja përtej zgjidhjeve të drejtuara nga tregu. Në këtë kuptim, artet dhe kultura janë një përgjigje e rëndësishme ndaj tensioneve kulturore, sociale, mjedisore, ekonomike e fetare, që ekzistojnë brenda shoqërive si në nivel rajonal po ashtu edhe atë Evropian.

Disa nga prioritetet e BE'së që ndërlidhen me artet dhe kulturën dhe që njëherit ndërlidhen edhe me nevojat për ndryshim e zhvillim në nivelin lokal dhe nacional janë evidentuar si në vijim:

Vlerat evropiane dhe të drejtat e njeriut: Çdo ditë, artistët dhe profesionistët e artit mbrojnë vlerat e trajtuara në Kartën e të drejtat themelore. Qasja dhe pjesëmarrja në jetën kulturore është njohur si një e drejta themelore për individët, duke ndihmuar në krijimin e përmbushjes individuale dhe kolektive në shoqëri

Përfitimet dhe rritja ekonomike: Sektori kulturor është një nxitës i dëshmuar për ekonominë dhe rritje të qëndrueshme. Si shembull, në Francë, ajo sjell një vlerë të shtuar prej 57,8 miliardë euro të ekonomisë, e cila është 3,2% e shumës së të gjitha vlerave të shtuara.

Edukimi: Pjesëmarrja në aktivitetet e strukturuar të artit rritë aftësitë njohëse dhe këtë e dëshmojnë studimet, që nxënësit nga familjet me të ardhura më të ulëta që marrin pjesë në





aktivitete artistike në shkollë, tre herë ka më shumë të ngjarë të marrë një diplomë sesa fëmijët me të njëjtin prejardhje që nuk merren me arte aktivitetet në shkollë.

Kohezioni social: Pjesëmarrja në aktivitetet kulturore është një mjet thelbësor për individët dhe komunitetet për të komunikuar, për të përcaktuar dhe zhvilluar identitetin e tyre, për të dalluar veten nga të tjerët. Kjo i lejon njerëzit e izoluar ose të marginalizuar të fitojnë aftësi, të rrisin vetë-besimin dhe vetëvlerësimin.

Migrimi dhe qytetaria: Kultura dhe artet i mësojnë individët për kompleksitetin dhe kontribuojnë në përvojën konstruktive të "tjetërsisë". Ato pasqyrojnë "jetesën tonë së bashku", ato na stimulojnë të çmojmë dallimet dhe të zbulojmë afinitetet. Në nivel lokal artistët dhe profesionistët e arteve janë të përkushtuar dhe merren me sfidat e reja shoqërore.

Inovacioni: Platformat e reja teknologjike janë duke u zhvilluar për t'i dhënë akses kulturës, audiencës globale dhe grupeve të cenueshme në shoqëri.

Shëndeti dhe mirëqenia: Njerëzit që marrin pjesë në ngjarje kulturore kanë më shumë gjasa të rezultojnë me shëndet të mirë dhe kërkimet kanë dëshmuar se një frekuencë më e lartë e angazhimit me kulturën dhe artet në përgjithësi, shoqërohet me një nivel më të lartë të mirëqenies. Kultura dhe artet nxisin ndryshimet në mënyrat e reja të të jetuarit dhe punuarit.

Zhvillimi rajonal dhe urban: Kultura është një mjet i fuqishëm për rigjenerimin urban, zhvillimin dhe kohezionin social. Prania e aktiviteteve kulturore është një faktor kryesor në atraktivitetin e rajoneve dhe qyteteve.

Bashkëpunimi dhe zhvillimi ndërkombëtar: Në përgjithësi, kultura dhe artet mundësojnë një qëndrueshmëri sociale, ekonomike dhe zhvillimin njerëzor. Ato gjithashtu lehtësojnë dialogun midis kulturave që duket të jetë një kusht thelbësor i bashkëjetesës paqësore.

Sfidat mjedisore: Kultura është një mjet i fuqishëm në adresimin e sfidave mjedisore, duke inspiruar e fuqizuar artet, kulturën dhe shkencën si përbërësit kyq të një qyteti elastik dhe të qëndrueshëm.

Roli ynë

7Arte është një organizatë e cila në mes të aktiviteteve kulturore, artistike dhe sensibilizuese e vetëdijeson, promovon dhe zhvillon jetën socio-kulturore në regjionin e Mitrovicës e më gjerë. Ne besojmë në një të ardhme të shëndoshë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, andaj aktivitete tona përqendrohen në ofrimin e mjediseve më gjithëpërfshirëse, informuese e rekreative, ku të rinjtë e gratë krahas argëtimit mund të zhvillojnë të menduarit kritik, rrisim pjesëmarrjen në proceset vendimarrëse, zhvillojnë një shoqëri të hapur e demokratike, si dhe të ngrisin kapacitetet e tyre profesionale e kreative. Njëherit, ne besojmë se arti, kultura dhe mjedisi luajnë një rol të veçantë në krijimin e një harmonie multi-etnike, gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të një shoqërie të qëndrueshme dhe të zhvilluar.

Analiza

Me përvojën dhe punën tonë shumë vjeçare, jemi të vetëdijshëm se bota është duke tejkaluar transformime dhe zhvillime të ndryshme në trendet e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe mbrojtjes së planetit. Andaj gjatë rishqyrtimit të strategjisë tonë në konsultim me "Kaleidoscope Futures Lab" dhe modelin e tyre të 'Forcave Fragmentuese' kemi arritur në përfundim se zhvillimi i mëtejshëm i organizatës tonë duhet të përqëndrohet ndaj promovimit dhe implementimit të praktikave pozitive dhe shërbimeve inovative për një të ardhme të qëndrueshme të rajonit. Njëherit, duke shqyrtuar edhe dokumentin "Agenda 21 për Kulturën" (2004) miratuar nga qytetet dhe qeveritë lokale të botës që janë të përkushtuar ndaj të drejtave të njeriut, diversitetit kulturor, qëndrueshmërisë, demokracisë pjesëmarrëse dhe krijimit të kushteve për paqen, kemi arritur në përfundim të ndërtimit të strategjisë dhe aktiviteteve duke pas për bazë këto shtylla: Shoqërinë, Ekonominë, Kulturën dhe Mjedisin.

Misioni dhe Vizioni

Misioni i organizatës: (që nga themelimi më 2006)

Të mbështes artistët Kosovarë; të zhvillojë e promovojë një kulturë të përbashkët Evropiane.

Vizioni i organizatës:

Të fuqizoj artet, kulturën dhe industrinë kreative si një forcë drejt krijimit të një regjioni gjithëpërfshirës, paqësor dhe të qëndrueshëm.

Objektivat strategjike

Prej të cilave janë nxjerrë tri programe e qëllime strategjike, kyçe:

Objektivi Strategjik 1: *Mbrojtja dhe promovimi i vlerave kulturore-artistike*

Objektivi Strategjik 2: *Fuqizimi i të rinjëve të rajonit të Mitrovicës*

Objektivi Strategjik 3: *Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në rajonin e Mitrovicës;*



I. MBROJTJA DHE PROMOVIMI I VLERAVE KULTURORE-ARTISTIKE

Ky program ka për synim zhvillimin e politikave kulturore, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave kulturore e artistike të të gjithë vendit, duke u fokusuar në proceset vendimmarrese ne nivel vendi dhe nacional, në nismat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (materiale e shpirtërore), si dhe përfshirjen e promovimin e artistëve nga artet vizuele e bashkohore në nivel vendi si dhe në atë ndërkombëtarë.



Projektet aktive:

Hapësirat Kulturore të Kosovës - projekt i cili zhvillohet ne bashkepunim me Anibar, Lumbardhi dhe Pogon dhe synon të forcojë skenën e pavarur kulturore duke nxitur partneritetin publiko-shoqëror për shfrytëzim sa më inovativ të hapësirave publike.

Human Rightivism - përmes së cilit mbështeten aktivitetet artistike e skenike duke përfshirë edhe pjesën veriore të qytetit.


Strategjia për Kulturë e Turizëm 2018-2022

Analizë mbi gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore në Mitrovicë, mbështetur nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga IKS dhe LENS dhe FES (2018-2019)

Rrjeti i Organizatave Kulturore- RROK Mitrovicë - 7Arte luan rolin e Sekretariatit të RROK-M dhe se njëherit ka qenë iniciuese për formimin e këtij rrjeti që në vitin 2017.

II. FUQIZIMI I RINISË

Ky program synon të ngris kapacitetet e të rinjve (me focus gruan dhe grupet e marginalizuara) në fushën e industrisë kreative, të zhvilloj të menduarit kritik, të nxisë vullnetarizmin, të stimulojë kreativitetin, tu ofroj mundësi për shkëmbim të njohurive në nivel ndërkombëtarë, të ofroj hapësirë pune, si dhe tu mundësoj përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në proceset e vendimarrëse në nivelin lokal.




Projektet aktive:

“Këndi Kreativ” është një vend-takim i hapur për të rinjtë të cilët mund të diskutojnë dhe të zhvillojnë idetë e tyre të reja në mënyrë që të bëjnë ndryshime pozitive në shoqëri, si në nivel lokal dhe atë nacional. “Këndi Kreativ” posedon bibliotekën me më shumë se 1600 libra, si dhe njihet si vendtakim i të rinjve nga komunitetet e ndryshme.

101 shkallët - promovon brezin e ardhshëm të artistëve. Ky është një program i promovimit dhe zhvillimit të mëtejshëm profesional për artistët e rinj 18-24 vjeçar, i cili përfshinë ofrimin e skenës dhe paisjeve të nevojshme për të ndihmuar muzikantët, poetët dhe artistët vizualë të Kosovës, me qëllim që të rriten drejt një karriere të qëndrueshme në art.

III. PROMOVIMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Për të zhvilluar këtë program, organizata 7Arte inicion dhe mbështet ide inovative se si të trajtohen problemet mjedisore, dhe se si të rritet niveli i kulturës së shoqërisë ndaj mjedisit. Ky program synon të krijoj bazat e para të ngritjes së kauzës për një mjedis të qëndrueshëm, duke marrë për bazë burimet natyrore, si dhe faktorët gjeografik e demografik që ka Mitrovica me rrethinë, për të ndërtuar një kauzë sa më gjithëpërfshirëse për të gjitha komunitetet që jetojnë në këtë qytet. Ne besojmë se çështjet mjedisore janë fillimisht çështje kulturore.





Projektet aktive:

- **“Green Festival”** është një festival multidiciplinar që përbëhet nga muzikë, ekspozita, debate, arte pamore, krijim filmi, arsim, zejtari dhe panairë dhe gjithashtu kombinon të gjitha aktivitetet drejt ndërgjegjësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- **Green School** - Shkollë verore e joformale për dizajnimin dhe hartimin e planeve rivitalizuese të hapësirave të pashfrytëzuara në qytetin e Mitrovicës, përfshirë ato në zonat industriale.
- **Mobile Open Culture and Innovation (MOCI)** është rrjet rajonal i ndërtuesve të komuniteteve që punojnë në bashkëpunim drejt shoqërive të drejta dhe të barabarta, në të cilat të gjithë mund të përparojnë. Ne inkurajojmë dhe kontribuojmë drejt krijimit dhe zhvillimit të komuniteteve të qëndrueshme dhe elastike në Ballkan. 7Arte është iniciuese dhe organizatë anëtare e rrjetit ballkanas MOCI. Për më shumë vizitoni moci.space

Strategjia implementuese

I. **Objektivi: Avokimi dhe fasilitimi i hartimit të rregullores për menaxhimin e trashëgimisë kulturore**

Aktivitetet e përgjithshme: Ndërtimin e raporteve dhe partneritetit me institucionet lokale me qëllim të bashkëpunimit në fushat e hartimit të politikave lokale. Asistimin në thirrjen publike të qytetareve e audienceës së synuar për pjesëmarrje në tubimet publike, fokus grupe, intervista e pjesëmarrje aktive në proceset vendimmarrëse. Avoksimin e vazhdueshëm dhe asistimin drejt organizimit të puntorive, debateve, fokus-grupeve, drejt hartimit të draftit të parë të Planit për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore për Komunën e Mitrovicës Jugore. Monitorimin e institucioneve drejt mbikqyrjes së mos/implementimit të strategjive të miratuara si ajo për Kulturë e Turizëm 2018-2022, e që ndërlidhen me interesat e grupeve tona të interesit. Avokimin mbi çështjet ad-hock e të paparashikuara, që mund të prekin drejtpërdrejte apo indirekt komunitetin, apo grupet e marginalizuara.

II. **Objektivi: Fuqizimi i programit artistiko- kulturor në “Këndin Kreativ”**

“7Arte” do t’i ofrojë program të vazhdueshëm social e kulturor, duke i siguruar 10 aktivitete kulturore përgjatë një muaji, apo rreth 100 aktivitete gjatë gjithë vitit. Krahas kësaj, do u krijoj të rinjve mundësi për shkëmbime kulturore në nivel rajonal dhe atë ndërkombtarë.

Aktivitetet e përgjithshme: Hartimi i programit 12-mujor, angazhimi i vullnetarëve dhe praktikantëve, riparimi i disa pjesëve të hapësirës, sigurimi inventarit, promovimi i kalendarit të aktiviteteve, zhvillimi i audiencës, lidhja e artistëve të rinj me tregun e punës, vizita studimore në

studio, produksione, media qendrore, galeri,e qendra të kulturës, si dhe promovimi i tyre në mediat qendrore, kombëtare e ndërkombëtare.

III. Objektivi: *Zhvillimi dhe promovimi i mëtejshëm i “Green Festival - edicioni i 12 - 14”*

Festivali GREEN është një projekt kulturor që ngërthen në vete diciplina të ndryshme të artit si: muzikën, filmin, intervenime artistike në hapësira publike, si dhe nxitje të inovacionit, me qëllim të aktivizimit dhe promovimit të artistëve kosovarë drejt zhvillimit të jetës kulturore dhe socio-ekonomike në vend.

Duke ditur se festivali Green Fest i sinkronizon tematikat sipas rendites së Qëllimeve globale për zhvillimin e qëndrueshëm, në tre vitet në vijim, festivali do të trajtojë temat: “Komunitete dhe qytete të qëndrueshme” e “Modelet e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm” e “Ruajtja e klimës”. Temat kurohen në përputhje me rrethanat dhe nevojat lokale të evidentuara nga komuniteti, si dhe trajtohen përmes qasjeve kreative. *Aktivitetet e përgjithshme*: Green School, Green Cinema, Green Music, Instalacione artistike në hapësira publike, Green Talks, Aktivitete mjedisore, Kids program, etj.


Rrjetëzimi

7Arte është në pritje të konfirmimit për antarësim në rrjetin e Qendrave Kulturore të Evropës- (**European Network of Cultural Centers - ENCC**), prej së cilëve ka gjetur mbështetje në projektin e realizuar së fundmi në partneritet me Tek Bunkerin.

Mobile Open Culture and Innovation (MOCI) është rrjet ballkanas i ndërtuesve të komuniteteve që punojnë në bashkëpunim drejt shoqërive të drejta dhe të barabarta, në të cilat të gjithë mund të përparojnë.

7Arte është antare e **Youth Environment Europe - YEE** që nga viti 2017 dhe vazhdimisht delegon të rinj për të ngritur kapacitetet e tyre në fushat mjedisore si dhe bashkëpunon në projekte të ndryshme të kësaj natyre.

Njëherit, 7Arte është e akredituar nga **European Solidarity Corps**, për dërgim dhe pranim të vullnetarëve nga shtetet ndryshme evropiane e të Ballkanit





Plani i Veprimit

Plani i punës i organizatës																		
Aktivitetet kryesore të programit	2021									2022				2023				
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
Punëtori			x	x							x				x	x		
Fokus grupe				x	x						x	x				x	x	
Debate publike					x				x			x					x	
Evente kulturore publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Green Festival (aktivitete multidiciplinare)						x	x	x	x			x	x			x	x	x
Zhvillim të kapaciteteve të brendshme të org	x	x	x							x			x	x	x			x
Avokim/Monitorim të institucioneve relevante e lokale				x		x		x		x			x		x			x
Promocion dhe vizibilitet në media/ueb/rtv	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	
Monitorim dhe vlerësim i programit			x			x			x			x			x			x
Auditimi i jashtëm financiar										x	x			x				x

Monitorimi dhe Vlerësimi

Strategjia e organizatës 7Arte mbulon periudhën trevjeçare. Strategjia është subjekt i përvitshëm rishikimi dhe rregullimi në varësi të qëllimeve të parashikuara. Rishikimi i strategjisë do të varet nga vizionet alternative dhe vendimet që rrjedhin nga konsultimet me të gjithë aktorët e sektorit kulturor-artistik, e komunitetin që njëherit e konsiderojmë grup të synuar.

Pasi miratimit të dokumentit të Strategjisë, do të përpunohet një plan veprimi 1-vjeçar. Plani i Veprimit do të rishikohet në fund të çdo viti, me çrast aktivitetet do të përcaktohen për vitin e ardhshëm, vijues. 7Arte është përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë; e cila do të analizojë çdo vit ndryshimet e prodhuara nga zbatimi i Strategjisë dhe do të vlerësojë rezultatet e arritura. Plani i veprimit, i cili konsiderohet si instrument për ekzekutimin e detyrave të strategjisë, do t'i nënshtrohet një monitorimi dhe vlerësimi nga trupa menaxheriale duke përgaditur e paraqitur raporte mbi ecurinë, dy herë në vit.

Për të siguruar transparencën dhe angazhimin publik, 7Arte do të iniciojë krijimin e Grupit për Monitorimin e Strategjisë, i cili së bashku me Kryesinë e Kuvendit do të monitorojnë zbatimin e objektivave të strategjisë dhe kur është e nevojshme, do të propozojë rekomandime. Për të vlerësuar zbatimin e strategjisë në fazat e përvitshme do të përgatiten raportet përkatëse afatmesme dhe përfundimtare.



7 Arte

Sheshi "Mehe Uka"

Biblioteka e qytetit, kati VI

Mitrovicë 40000

Republika e Kosovës

+383(0)38 748 861

info@7-arte.org

www.7-arte.org



7 arte